MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Nr. 1830/6 Prot.
Datë 23.05.2022

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRI

URDHËR

Nr. 88, datë 20.5.2022

PËR

MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË ORGANIKËS SË MINISTRISË SË BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, të nenit 7, të ligjit nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, të nenit 7, të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", dhe të nenit 21, të ligjit nr.90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore",

URDHËROJ:

1. Struktura e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të jetë sipas skemës 1, që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Organika e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të jetë sipas skemës 2, që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Numri i punonjësve të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të jetë, gjithsej, 180 veta.

4. Urdhri nr.150, datë 19.11.2020, i Kryeministrit, "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural", i ndryshuar, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

SKEMA 1

STRUKTURA E MINISTRISË SË BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL